

V E N D I M
Nr.507, datë 24.10.1994

PËR KONTROLLIN E LLOGARIVE TË VITIT 1994

Mbështetur në nenin 17 të ligjit nr.7661, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin” dhe në dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” lidhur me kontrollin ligjor të llogarive të ndërmarrjeve shtetërore, të shoqërive tregtare dhe të subjekteve të tjera që ushtrojnë veprimtari ekonomike me qëllim fitimi, duke pasur parasysh që profesioni i ekspertit kontabël të autorizuar nuk është rregulluar ende në mënyrë përfundimtare, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Llogaritë vjetore për vitin 1994 të subjekteve që tregohen më poshtë, do të kontrollohen nga ekspertë kontabël të pavarur:

a) Ndërmarrjet shtetërore që i nënshtrohen ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”.

b) Shoqëritë tregtare anonime.

c) Shoqëritë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, të cilat kanë tejkaluar dy nga tre treguesit e parashikuar në nenin 65 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

ç) Ndërmarrjet private individuale, të cilat kanë tejkaluar treguesit e përcaktuar në nenin 10, paragrafi 2 i ligjit nr.7661, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin”.

d) Ndërmarrjet, shoqëritë ose firmat e administruara nga parti politike, shoqata a organizata profesionale, të cilat, pavarësisht nga emërtimi e statusi juridik i tyre, ushtrojnë veprimtari ekonomike me qëllim fitimi dhe përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 10, paragrafi 2 i ligjit nr.7661, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin”.

dh) Shoqëritë e huaja ose filiale të tyre që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, shoqëritë e përbashkëta me pjesëmarrje të kapitalit të huaj dhe shoqëritë vendase, të cilat deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi nuk kanë të caktuar ekspertë kontabël të autorizuar ose kanë të caktuar vetëm ekspertë të huaj.

2. Ekspertët kontabël të autorizuar për kontrollin e llogarive sipas pikës 1 të këtij vendimi caktohen për çdo rreth nga ministri i Financave. Për çdo rreth ministri i Financave cakton një përgjegjës të grupit të ekspertëve.

Lista e ekspertëve kontabël të çdo rrethi u dërgohet zyrtarisht nga ministri i Financave:

- gjykatave të rretheve;

- bashkive, këshillave të rretheve, ministrive dhe institucioneve qendrore të interesuara;

- gjykatës së regjistrimit tregtar.

Gjykatat e rretheve dhe, nëse është e nevojshme, organet e tjera të përmendura më sipër, i shpallin këto lista në vende të dukshme në lokalet e tyre.

3. Emërimi i ekspertëve kontabël për çdo ndërmarrje, shoqëri tregtare ose subjekt tjetër bëhet nga organi kompetent që është parashikuar në ligj, por gjithnjë brenda listës së miratuar nga ministri i Financave.

Në mungesë të emërimit nga organi kompetent eksperti caktohet nga gjykata e rrethit me kërkesë të përgjegjësit të grupit të ekspertëve të rrethit.

Për emërimin e ekspertëve kontabël mbahen parasysh ndalesat dhe papajtueshmëritë e parashikuara në ligjin “Për shoqëritë tregtare”.

4. Ekspertët kontabël të pavarur që do të kryejnë kontrollin e llogarive sipas këtij vendimi, duhet të jenë specialistë kontabël e finance që përmbushin këto kushte:

- të kenë mbaruar arsimin e lartë;

- të kenë një përvojë pune në fushën e kontabilitetit e të kontroll-revizionit jo me pak se shtatë vjet.

Megjithatë, përjashtimisht për rrethet që nuk kanë specialistë të tillë ose janë të pamjaftueshëm, mund të caktohen ekspertë me arsim të mesëm profesional me një përvojë pune mbi 10 vjet. Në rast se edhe kjo nuk arrihet, ministri i Financave ka të drejtë të caktojë ekspertë kontabël

në një rreth, ekspertë nga një rreth tjetër.

Specialistët që kanë ndjekur kurset e formimit profesional në ciklin “Njohuri të thelluara për sistemin kontabël të ri” kanë përparësi në caktimin për ekspert kontabël, kur përmbushin kushtet e treguara më sipër. Gjithashtu kanë përparësi pedagogët e universiteteve që japin lëndët financë-kontabilitet.

Nuk mund të caktohen ekspertë kontabël punonjësit e organeve të kontroll-revizionit, të organeve tatimore, të organeve të policisë financiare dhe të shërbimit të kontrollit të shtetit, si dhe të punësuarit në subjektet ekonomike dhe në banka.

5. Shpenzimet për kontrollin e llogarive të vitit 1994 janë në ngarkim të subjekteve, llogaritë e të cilave do të kontrollohen.

Kuota e pagesës do të caktohet nga organi kompetent i ndërmarrjes ose shoqërisë tregtare në marrëveshje me ekspertin që kërkohet të emërohet a caktohet për kontrollin e llogarive.

Në varësi nga madhësia e ndërmarrjes dhe kompleksiteti i veprimtarisë, këto kuota vendosen brenda këtyre kufijve:

- për ndërmarrjet shtetërore, shoqëritë anonime, shoqëritë e huaja dhe ato me kapital të përbashkët nga 12 mijë deri në 16 mijë lekë;

- për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar nga 10 mijë deri 12 mijë lekë;

- për ndërmarrjet dhe subjektet e tjera të parashikuara në pikën 1 nga 8 mijë deri 10 mijë lekë.

6. Kuotat e arkëtuara për kontrollin e llogarive të vitit 1994 shpërndahen si më poshtë:

- 90 për qind për shpërblimin e ekspertit kontabël që ka kryer kontrollin.

- 7 për qind për shpenzimet administrative për funksionimin e grupit të ekspertëve kontabël.

- 3 për qind mbetet në buxhetin e Ministrisë së Financave për të përballuar kostot e udhëtimeve dhe shpenzimet e tjera për funksionimin e grupeve të ekspertëve.

Përgjegjësi i grupit të ekspertëve kontabël të rrethit ka të drejtën e një shpërblimi suplementar në masën pesëdhjetë për qind të shpërblimit mesatar të llogaritur për një anëtar grupi.

7. Kuotat për kontrollin e llogarive vjetore të vitit 1994 do të depozitohen në llogari të posaçme pranë degëve të thesarit në rrethe dhe do të administrohen si të ardhura që u përkasin 100 për qind institucioneve buxhetore.

Tërheqja e tyre për shpërblimin e anëtarëve të grupit të ekspertëve kontabël dhe për shpenzimet e tjera të grupit do të bëhet me urdhër të përgjegjësit të grupit, sipas procedurave të caktuara nga Drejtoria e thesarit. Pjesa e Ministrisë së Financave përdoret e përqendruar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

8. Përgjegjësi i grupit të ekspertëve kontabël organizon mbajtjen e llogarive për të ardhurat dhe shpërzimet e grupit. Për këtë ai mund të angazhojë një llogaritar me pagesë, e cila nuk mund të jetë më shumë se pesëdhjetë për qind e shpërblimit mesatar të llogaritur për një anëtar të grupit.

9. Ekspertët kontabël që para daljes së këtij vendimi kanë qenë të emëruar në shoqëritë e huaja ose filialet e tyre, në shoqëritë e përbashkëta dhe në shoqëritë e tjera, do të vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre.

Ata nuk përfshihen në listat e ekspertëve kontabël të parashikuara në këtë vendim dhe veprojnë në mënyrë të pavarur vetëm në shoqëritë ku janë emëruar.

Megjithatë shoqëritë ose ndërmarrjet e mësipërme duhet t'i komunikojnë zyrtarisht ministrit të Financave, brenda 15 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, emrin dhe mbiemrin e ekspertit a ekspertëve të emëruar, numrin dhe datën e aktit të emërimit, adresën e punës dhe funksionin që kryen.

11. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ngarkohet të përgatitë udhëzimet e nevojshme për kontrollin e llogarive të vitit 1994, të cilat miratohen nga ministri i Financave, si dhe të organizojë me ekspertët kontabël ose me përgjegjësit e grupeve të tyre kurse të formimit profesional për kontrollin e llogarive.

12. Organet tatimore dhe ato të statistikës në rrethe duhet të venë në dispozicion të përgjegjësve të grupeve të ekspertëve kontabël të dhëna për të identifikuar subjektet që në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi i nënshtrohen kontrollit të llogarive, pikërisht të dhëna për totalin e aktivitetit të bilancit, për të ardhurat dhe për numrin e të punësuarve.

13. Subjektet që nuk i nënshtrohen detyrimit për kontrollin ligjor të llogarive, por dëshirojnë ose kërkojnë të kontrollojnë llogaritë e tyre për vitin 1994, mund ta bëjnë këtë vetëm nga ekspertët e përfshirë në listën e miratuar nga ministri i Financave.

Edhe në këtë rast zbatohen kuotat e pagesës të përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi, si dhe rregullimet e parashikuara në pikat 6 dhe 7 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ka efekt vetëm për kontrollin e llogarive të vitit 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi